



**KONGRESI
RINOR
KOMBËTAR**



**BASHKIA
TIRANË**

PROCES PROKURIMI

SHËRBIM TRANSPORTI (AUTOBUZ OSE FURGON) PËR SHKOLLËN DIMËRORE NË KUADËR TË Projekti “ECO-YOU (th) TIRANA

Emri: ORGANIZATA YOUTH4SOCIETY

E-mail: info@youth4society.org

Afati i dorëzimit të ofertës: 5 NENTOR 2022

Informacion i përgjithshëm

Youth4Society është një organizatë jofitimprurëse, joqeveritare, jopolitike, e cila synon të nxisë pjesëmarrjen e të rinjve në shoqërinë civile, të sjellë ndryshime sociale, zhvillim dhe përmirësim të vendit tonë, duke përdorur mjete dhe programe të ndryshme. Të gjitha aktivitetet janë të fokusuar në fushën rinore.

Qendra për Ekselencë Destiny (këtu me tej QED ose DCE) është një organizatë jofitimprurëse, joqeveritare, jopolitike e cila ka si mision të kontribuojë për një qeverisje demokratike, kohezionin social, ruajtjen e trashëgimisë sonë, respektimin e dinjitetin njerëzor dhe të drejtave të njeriut, mbrojtjen e tokës përmes programeve të qëndrueshme. Misioni i DCE është i bazuar, i përafëruar plotësisht në Axhendën e 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm të miratuar nga Kombet e Bashkuara, e cila qëndron si një gur themeli i punës të DCE. E krijuar në vitin 2021 nga një ekip ekspertësh të kualifikuar ka si vizion një botë e barabartë dhe e begatë.

Informacion rreth projektit

Projekti “ECO-YOU (th) TIRANA“ i cili zbatohet nga Y4S dhe QED organizohet në kuadër të programit Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022 me mbështetjen financiare të Kongresit Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë.” Qëllimi i përgjithshëm i projektit është rritja e ndërgjegjësimit dhe kujdesit të rinisë ndaj mjedisit nëpërmjet aftësisë së tyre dhe praktikimit të të paktën një modeli, praktike apo sjellje pro-mjedisore nga vet të rinjtë në përditshmërinë e tyre. Specifikisht projekti synon të:

- rris kapacitetin rinor në fushën e mbrojtjes së mjedisit,
- të hulumtoj praktikën më të mira rajonale dhe Evropiane të kujdesit ndaj mjedisit të cilat rinia mund ti praktikoj dhe promovoj në përditshmërinë e tyre

Në kuadër të këtij projekti, organizata Youth 4 Society shpall procesin e prokurimit për shërbimin TRANSPORTI me Autobuz ose furgon sipas specifikimeve më poshtë



Kushtet për pjesëmarrje: Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese **deri më 5 Nëntor 2022**, në adresën e e-mailit: info@youth4society.org

Specifikimet teknike: Për këtë projekt, organizata do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktet dhe shërbimet sipas pershkrimeve në tabelën e mëposhtme:

Nr	Përshkrimi i shërbimit	Njësi	Çmimi në LEK për njësi Me TVSH	Vlera totale në LEK
1	Transport për 30 persona brenda Tiranës deri në 50 km (km e llogaritur për totalin e udhëtimit vajtje ardhje)	2		
2	Transport për 30 persona jashtë Tiranës deri në 100 km (km e llogaritur për totalin e udhëtimit vajtje ardhje)	1		
Total				

Kushte të përgjithshme:

- 1) Subjektet duhet të jenë të regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimet e kërkuara;
- 2) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email në adresën e organizatës info@youth4society.org brenda datës **5 Nëntor 2022**.
- 3) Paga e subjektit kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në LEK dhe TVSH të përfshihet në kosto/çmim, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) Ofertën financiare për çdo produkt sipas tabelës më sipër.
- 2) Ofrimi i këtij shërbimi kërkohet për periudhën **22-25 Nëntor 2022**

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.



**KONGRESI
RINOR
KOMBËTAR**



**BASHKIA
TIRANË**

Ankes i ofertës

Emri i Subjektit:

NIPT:

Nr	Përshkrimi i shërbimit	Njësi	Çmimi në LEK për njësi Me TVSH	Vlera totale në LEK
1	Transport për 30 persona brenda Tiranës deri në 50 km (km e llogaritur për totalin e udhëtimit vajtje ardhje)	2		
2	Transport për 30 persona jashtë Tiranës deri në 200 km (km e llogaritur për totalin e udhëtimit vajtje ardhje)	1		
Total				

Nënshkruar nga:

